



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1096/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), paraqitur kundër subjektit politik Alternativa, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më 19.11.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 21.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET si e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, me shenjën ZL.Anr.1096/2017 e datës 19.11.2017, kështu që subjektit politik Alternativa, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2,500.00 (dymijëepesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën ZL.Anr.1096/2017 me datë 19.11.2017 nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), ku ka pretenduar se me datë 19.11.2017 kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Gjakovë, Gentrina Nuka në rrjetin e saj social Facebook ka publikuar një status, me qëllim për të bërë thirrje për ta votuar Mimoza Kusari Lila. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është shkelur neni 36 par.1 pika b) e LZP.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Gjakovë, në profilin e saj në facebook, ka shpërndarë një postim në të cilin shihet se ka përmbajtje të fushatës zgjedhore në ditën e heshtjes zgjedhore, konkretisht me datë 19.11.2017 rreth ores 11:11 minuta, veprim ky që është në kundërshtim dhe me nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së e cila përcakton se: *“Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve*

politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Edhe përkundër kërkesës për përgjigje në ankesë, subjekti politik Alternativa nuk është përgjigjur në ankesën e parashtruar nga BIRN dhe Internews Kosova, në PZAP.

Andaj, PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik Alternativa është përgjegjëse për veprimet e saja pasi që ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku parashihet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr.1096/2017 më datën 21.11.2017



Kryesues i Panelit

Hasan Shala

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.